

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 71/2016, “PËR KONTROLLIN KUFITAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016, “Për Kontrollin Kufitar”, ka si qëllim implementimin e sistemit të informacionit paraprak i pasagjereve (API) në përputhje me Direktivën e Këshillit të BE-së 2004/82/EC datë 29 prill 2004.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj hartohet në përputhje me Programin Politik të Qeverisë dhe me Programin Analitik të Projekt Akteve për vitin 2019, të Ministrit të Brendshëm, si dhe në zbatim të Direktivës së Këshillit të BE-së 2004/82/EC datë 29 prill 2004.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016, datë 07.07.2016 “Për Kontrollin Kufitar” është hartuar si një domosdoshmëri për plotësimin e paketës së akteve ligjore në zbatim Direktives së Këshillit të BE-së nr. 2004/82/EC.

Hartimi i këtij projektligji është një nga aktet ligjore më të rëndësishme të kuadrit ligjor që rregullon implementimin e sistemit të informacionit paraprak i pasagjereve (API) në Shqipëri.

Zbatim i projektit do të mundësojë marrjen e informacioni paraprak për pasagjeret duke lehtësuar procese të rëndësishme për menaxhimin e kufirit, luftën kundër terrorizmit, trafikimit, veprime të tjera të kundraligjshme si dhe lehtësimin e qarkullimit të pasagjereve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe ndërkombëtar. Konkretisht është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 71/2016,

“Për Kontrollin Kufitar”, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe Direktiven e Keshillit të BE-së Nr. 2004/82/EC.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji synon përafrimin e plotë me Direktiven e Keshillit të BE-së Nr. 2004/82/EC.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 8 (tetë) nene.

Në nenin e parë përcaktohet se ne objektin e ligjit nr. 71/2016, datë 07.07.2016 “Për Kontrollin Kufitar” që përcakton rregullat për regjimin e kontrollit kufitar të personave që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, do të shtohet dhe transmetimi i informacionit paraprak për pasagjerin (API).

Në nenin e dytë përcaktohet se në “Perkufizimet” do të shtohen dhe tre koncepte me emertimet si me poshte vijon:

“API” është informacion paraprak për pasagjerin; dhe

“Autoritetet ligjzbatuese që operojnë në kufi” janë Policia Kufitare dhe e Migracionit dhe Autoriteti Doganor i RSH.

“Transportues” nënkupton çdo person fizik ose juridik, profesioni i të cilit është të sigurojë transportin e udhëtarëve nga ajri, deti dhe toka;

Neni i tretë dhe neni katërt përcaktojnë llojin e informacionit që ka detyrim të dergojnë kompanite ajrore, formatin që duhet të ketë ky informacion, koha kur duhet të dërgohet informacioni. Gjithashtu përcaktohen edhe afatet e ruajtjes së këtij informacioni dhe rastet specifike të ruajtjes së informacionit.

Në nenin e pestë përcaktohen sanksionet për transportuesin dhe pasagjerët, sanksione të cilat do të jenë proporcionale, efektive dhe dekurajuese duke përcaktuar kufijt minimal dhe maksimal të tyre dhe te drejtat e subjektit të sanksioneve.

Në nenin gjashtë përcaktohen efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe përcaktohet se këto efekte do të përballohen nga buxheti i shtetit.

Do vlerësohen efektet financiare për të blerë sistemin API së bashku me pajisjet hardëare dhe për të mundësuar dërgimin e të dhënave nëpërmjet një shpërndarësi të të dhënave (Data Broker) si shërbim vjetor.

1. Sistemi API + Hardëare
2. Shërbimin vjetor të të dhënave nëpërmjet Data Broker.....

Në nenin shtatë ngarkon Këshillin e Ministrave të nxjerri aktin nënligjor në zbatim të nenit 15/1, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Në nenin tetë përcaktohet se ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij ligji Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti i Aviacionit Civil.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektligji ka kontribuar Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur me në kuadër të iniciativës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, për të mbështetur implemtin e API-në në vendin tonë. Në të këtë grup, u angazhaun përfaqesues nga Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Implementimi i sistemit API do të shoqërohet me efektete financiare në sigurimin e programeve të nevojshme për përdorim, në transmetimin dhe marrjen e të dhënave nga kompanitë e transportit të pasagjerëve si dhe në mirëmbajtjen e sistemit në vazhdimësi.

Këto efekte finaciare duhet që të planifikohen dhe të mbulohen nga buxheti i shtetit ose të sigurohen nëpërmjet donacioneve nga partnerët ndërkombëtar.

Nëse Sitemi i Transmetimit të të Dhënave (programit) do të blihet:

- Kostoja e programit do të jetë rreth 1.7 milion Euro;
- Kostoja e instalimit do të jetë rreth 1000 Euro;
- Kostoja e mirmbajtjes do të jetë rreth 7-10% e kostos së sistemit, në vit;
- Kostoja e shkëmbimit të të dhënave do të jetë rreth 2000 Euro në muaj, konto që mund të ndryshojë më rritjen e numrit të pasagjerëve.

Nëse Sistemi i Transmetimit të të Dhënave do të sigurohet falas, siç po negociohet me Qeverinë e Sheteve të Bashkuara të Amerikës, (Department of Homeland Security), në kuadër të marrëveshjes për shkëmbimin e të dhënave të pasagjerëve:

- Kostoja e programit do të jetë 0;
- Kostoja e instalimit do të jetë 0;
- Kostoja e mirmbajtjes do të jetë 0;
- Kostoja e shkëmbimit të të dhënave do të jetë rreth 2000 Euro në muaj, kosto që mund të

ndryshojë më rritjen e numrit të pasagjerëve.